



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1096/Prot.  
2

Tiranë, më 10 /10/2017

VENDIM

Nr. 92, datë 10 / 10 /2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1096 Prot., datë 08.08.2017, ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 14.07.2017 ka kërkuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë t’i vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

1. Sa është buxheti për secilin vit shkollor 2015-2016, 2016-2017 për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes mësuesit ndihmës në shkallë vendi dhe specifikisht për DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
2. Sa është numri i nxënësve sipas llojit të aftësisë së kufizuar (për rastet e fëmijëve të spektrit autik kërkohet të jenë të kategorizuar më vete) në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
3. Lista e shkollave ku mësojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe numri i tyre për çdo shkollë në nivel kombëtar dhe specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.

4. Numri i mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara gjithsej për vitin 2015-2016 dhe veçmas për vitin shkollor 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
5. Numri i mësuesve ndihmës i ndarë për secilën shkollë për vitin 2015-2016 dhe veçmas për vitin shkollor 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
6. Numri i rasteve të vlerësuar nga Komisioni i ngritur sipas Udhëzimit Nr.38 datë 07.10.2014, për secilin vit shkollor 2015-2016, 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
7. Për sa raste u mor vendim për të vënë në dispozicion mësuesin ndihmës në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
8. Për sa raste u refuzua ofrimi i një mësuesi ndihmës në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
9. Sa mësues ndihmës kanë marrë trajnim për vitin shkollor 2015-2016 dhe 2016-2017, sa orë trajnimi ka përfutur secili mësues ndihmës, cilat tema dhe cilët ish-in ofruesit e trajnimit?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr.1096 Prot., datë 08.08.2017 pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri me shkresën nr. 1096/1 Prot., datë 10.08.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 17.08.2017. Në tejkalim të afateve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk ka kthyer përgjigje.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës konstatohet se, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Në këto rrethana rezulton se objekti i kërkesës përbën informacion publik dhe si i tillë i duhet vendosur në dispozicion të kërkuarit.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.



Për sa më sipër, në lidhje me ankesën e Z.

ndaj Autoritetit Publik,

Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

### V E N D O S A :

1. Pranimin e ankesës së Z. Nr. 1096 Prot., datë 08.08.2017, ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, sipas kërkesës të datës 14.07.2017, me objekt:
  1. Sa është buxheti për secilin vit shkollor 2015-2016, 2016-2017 për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes mësuesit ndihmës në shkallë vendi dhe specifikisht për DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
  2. Sa është numri i nxënësve sipas llojit të aftësisë së kufizuar (për rastet e fëmijëve të spektrit autik kërkojmë të jenë të kategorizuar më vete) në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
  3. Lista e shkollave ku mësojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe numri i tyre për çdo shkollë në nivel kombëtar dhe specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
  4. Numri i mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara gjithsej për vitin 2015-2016 dhe veçmas për vitin shkollor 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
  5. Numri i mësuesve ndihmës i ndarë për secilën shkollë për vitin 2015-2016 dhe veçmas për vitin shkollor 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
  6. Numri i rasteve të vlerësuar nga Komisioni i ngritur sipas Udhëzimit Nr.38 datë 07.10.2014, për secilin vit shkollor 2015-2016, 2016-2017 në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
  7. Për sa raste u mor vendim për të vënë në dispozicion mësuesin ndihmës në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës?
  8. Për sa raste u refuzua ofrimi i një mësuesi ndihmës në nivel kombëtar dhe sa specifikisht në DAR-et Korçë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Kukës.
  9. Sa mësues ndihmës kanë marrë trajnim për vitin shkollor 2015-2016 dhe 2016-2017, sa orë trajnimi ka përfituar secilin mësues ndihmës, cilat tema dhe cilët ishin ofruesit e trajnimit; brenda datës 18.10.2017.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “ Pë të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot në datë 10. 10.2017.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

